



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KRYETARI

Nr. 358/Prot.
2

Tiranë, më 14.06 2019

Lënda: Kërkesë për riklasifikim në kategorinë e pagave dhe shpësë të numrit të punonjësve për Kolegjin e Posaçëm të Apelit

Z. Gramoz Ruçi
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Për dijeni: OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT
Rruga e Kavajës, ish-godina e "Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve", Tiranë

I nderuar z. Ruçi,

Kolegji i Posaçëm i Apelit është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b, paragrafi 5, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe si një gjykatë me juridiksion disiplinor.

Kolegji i Apelit, në përmbushje të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, mbështetet nga personeli këshillimor dhe punonjësit administrativë. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 92/2017, i ndryshuar me vendim nr. 101/2018, ka miratuar strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Apelit. Aktualisht është rekrutuar i gjithë personeli i Kolegjit prej 43 punonjësish.

1. Kolegji i Apelit me shkresat nr. 358, datë 10.05.2018, dhe nr. 358/1, datë 29.06.2018, i ka drejtuar Kuvendit të Shqipërisë kërkesën për ndryshim në kategorinë e specialistëve nga IV-a dhe IV-b në III-b, për 6 (gjashtë) poste pune të strukturës organike, për specialistë të profileve të ndryshme (specialist sekretarie gjyqësore, specialist pritje populli/zbardhje vendimesh/protokollist). Me vendimin nr. 101/2018, janë plotësuar pjesërisht kërkesat tona dhe është kryer riklasifikimi në kategorinë III-b vetëm për 3 (tre) poste pune (specialist sekretarie gjyqësore).

Në këndvështrimin tonë, bazuar në trajtimin e pagës së punonjësit specialist të Gjykatës Kushtetuese, mendojmë se është i nevojshëm riklasifikimi i pagës në kategorinë III-b edhe për

3 (tre) postet e mbetura (specialist pritje populli / zbardhje vendimesh / protokollist) . **Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi është 504 mijë lekë.**

2. Referuar nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës, Kolegji i Apelimit funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si kolegji i dytë i saj. Me qëllim ndihmën e Kryetarit të Kolegjit në pjesën administrative të institucionit, si dhe në analogji me Gjykatën Kushtetuese, vlerësohet se është e nevojshme **një rritje e numrit të punonjësve me 2 (dy) vetë**, përkatësisht: Drejtor Kabineti/K 1 (një) dhe Këshilltar Kabineti/K 1 (një).

Kabineti i Kryetarit, do të ketë të njëjtin funksion që ka në Gjykatën Kushtetuese në mbështetje të Kryetarit në realizimin e kompetencave të përcaktuara në nenin 13 të ligjit 84/2016, në legjislacionin e zbatueshëm brenda kufijve të kompetencave të Kryetarit, Rregullores së Veprimtarisë së Kolegjit të Apelimit, si dhe detyrave të ngarkuara me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve. **Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi është 4.3 milionë lekë.** Kjo kërkesë ka qenë pjesë e strukturës organike të paraqitur për miratim nga Kuvendi i Shqipërisë, në momentin e konstituimit të institucionit në muajin Shtator 2017 si edhe gjate kërkesës së paraqitur për shtesë strukture gjatë vitit 2018.

Në nenin C/16 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet: *“Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe komisionerët publikë kanë buxhet, administratë dhe mjedise të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre si edhe për ushtrimin e funksioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë, sipas ligjit”.*

Në pikën 1 të nenit 18 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. përcaktohet: *“Institucionet e rivlerësimit kanë personel dhe pajisjet e nevojshme për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga ky ligj”.*

Për sa parashtruam më sipër, lutem marrjen në konsideratë të kërkesës emergjente për shtimin me 2 punonjës të strukturës organike për vitin 2019, si dhe ndryshimin në klasifikimin e pagës për 3(tre) pozicionet e mbetura “Specialist”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

